



Autorë: Zenelabedin Latifi dhe Labinot Kunushevci

Ta përshkruash gjendjen ekonomike të një vendi kërkon kohë dhe mund, por gjithashtu edhe precizitet. Ne morëm përsipër të shkruajmë për disa çështje ekonomike të Kosovës dhe Maqedonisë, por në një kontekst vetëm sipërfaqësor, duke mos hyrë aq edhe në imtësira dhe vlera numerike.

Ajo që e mban një shtet dhe që e bën atë të fuqishëm është ekonomia, pra pasuria e një shteti është ekonomia.

Në këtë trajtim kemi të bëjmë me disa terme ekonomike, ku në vazhdim do t'i cekim më kryesoret, dhe pas të cilave do të vijë edhe analiza që e cekëm më lartë.

Rroga është sasia e të hollave që jepet si kundërvlerë për punën e kryer. Varësisht nga marrëveshja në mes të punëmarrësit dhe punëdhënësit rroga jepet për disa orë brenda ditës ose muajit. Zakonisht për marrëveshjet afatgjata rrogat jepen për orët e punës brenda një muaji dhe quhen rroga mujore, mirëpo në feudalizëm, kapitalizëm dhe sistemet tjera ku sindikatat nuk janë të plotfuqishme, rrogat jepen edhe për disa orë të dhëna pune brenda ditës apo javës.

Paga është sasia e të hollave që jepet si kompensim i punës së dhënë që zakonisht paguhet për muaj. Përndryshe paga merret edhe si të ardhura mujore të nënpunësve dhe të punësuarve tjerë që për bazë nuk i kanë orët e punës por paguhen sipas marrëveshjes në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Çdo punëtor përgjithësisht nuk është i kënaqur me rrogën që e merr, normalisht si njeriu që çdoherë kërkon më shumë se sa ka në disponim. Por rroga e punëtorit në Kosovë (kjo vlen edhe për në Maqedoni dhe disa shtete fqinje të tjera) është e ulët për të mbuluar harxhimet. Pakënaqësia e punëtorit arrin deri tek shkalla kur ai detyrohet ta braktisë punën, kurse në rastet e varfërisë së skajshme, ai punon edhe për një pagë të ulët.

Në një pyetje drejtuar në rrjetin social Facebook qytetarëve të Kosovës: „Çka mendoni për rrogat në Kosovë?“ Morëm përgjigje që pritnim, si për shembull: Mjerim; Katastrofale, nuk e di si po mbijetojmë; Nuk janë rroga por tallje për të mashtruar popullin; Sa një ndihmë sociale; kurse një përgjigje ishte pak qesharake ku thuhet se a merr ndokush rrogë pos atyre që janë në pushtet!

Normalisht se njerëzit çdoherë mundohen që të kenë një jetë sa më të mirë. Kjo gjë arrihet me punë, e cila pastaj duhet të paguhet nga punëdhënësi. Por, në Kosovë shihet se ka një rini të papunësuar, shumica e të cilëve kanë humbur vullnetin për punë si pasojë e pagave të ulta. Çdo gjë priset nga koka, edhe me shtetin ashtu ndodh. Kur shohim udhëheqësit e shtetit marrin rrogë mujore më shumë se një qytetar që merr gjatë tërë vitit. Të mos mundesh ta furnizosh një shtet me më pak se 2 milionë banorë dhe të vuan ai popull nga varfëria është turp. Për t'i dhënë vullnet punëtorit që të punojë, duhet paguar aq sa e meriton e jo vetëm një rrogë sa për sy e faqe. Së paku rroga duhet të jetë e lartë aq sa i mbulon të gjitha tatimet dhe harxhimet, dhe që mundëson një jetë normale dhe një mirëqenie ekonomike.

Sipas një raporti të fundit të vitit 2011 që ka të bëjë me mjedisin në Kosovë ku janë nxjerrë edhe fakte mbi gjendjen ekonomike, thuhet se nëse bazohemi në definicionin se e varfër konsiderohet ekonomia familjare me më pak se 2\$ në ditë, atëherë del se në vitin 2004 në Kosovë jetonin 60.6% e popullsisë (12.9% në varfëri ekstreme nën 1\$ për banorë, 47.6% në varfëri të plotë me 2\$ për banorë në ditë). Në krahasim me vitin 2000 nuk vërehet ndonjë përmirësim sa i përket shkallës së varfërisë në Kosovë, por niveli i varfërisë ekstreme tregon rritje nga 11.9% (2000) në 12.9% (2004), kurse niveli i varfërisë së plotë është i njëjtë dhe përfshinë më tepër se gjysmën e popullsisë (50.3%). Komunitat me popullsi shqiptare karakterizohen me shkallë më të lartë të varfërisë, kurse komunitat me popullsi shumicë serbe karakterizohen me shkallë më të ulët të varfërisë. Shpërndarja e varfërisë sipas vendimeve tregon se varfëria kombëtare më e lartë është në vendbanimet rurale, kurse varfëria e skajshme (ekstreme) më e lartë është në vendbanimet urbane.

Kosova si shtet ka nivelin më të ulët të të ardhurave për kokë banori në Ballkan dhe Europë. Faktikisht është prej shteteve me më së paku të ardhura për kokë banori. Pas viteve të 80-ta, përkeqësimi i situatës ekonomike në Kosovë është shprehur me zvogëlimin e të ardhurave për kokë banori. Anë pse nga viti 2000 të ardhurat për kokë banori kanë fillu të rriten paksa falë disa ndihmave e donacioneve të ndryshme, e shumë pak nga zhvillimi ekonomik i vendit. Por gjithmonë me ndihma, donacione e lëmosha nuk jetohet! Duhet të gjallërohem edhe vet.

Në një pyetje në rrjetin social Facebook se „si është situata ekonomike në vendin tuaj“ morëm përgjigje të llojit të njëjtë: Presheva thuhej se është në mjerim, në Mitrovicë nuk ka punë, të rinjtë vetëm sillen rrugëve, qytetarë nga Librazhdi (qytet në juglindje të Shqipërisë) thonin se është bërë për të të ardhur keq, kurse disa të tjerë nga qytete të tjera thonë se mënyra e vetme është emigrimi ngase në trojet tona është bërë krizë e madhe.

Dhe këtë e shohim se si shumë të rinjë që se kanë pasur fatin të gjejnë perspektivë ekonomike

në vend, e presin me mallë liberalizimin e vizave dhe gjithmonë kur përmendet papunësia dhe zhvillimi i vogël ekonomik bashkë me mbijetesën, ata thonë se nga kriza mund të dilet vetëm nëse emigrojnë diku në ndonjë shtet më përparimtar në Europë. Vërtetë kjo e dhimbshme! Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe shkalla e lartë e papunësisë si shkaktarët kryesorë të varfërisë në Kosovë, po e ngufasin dita-ditës rininë tonë. Vështirë të jetohet në një vend ku s'mund ta sigurosh as kafshatën e gojës e as të sigurosh strehë mbi kokë.

Është gjë normale se rinia nuk do të aktivizohen dhe nuk do të punojnë kur nuk marrin shpërblimin e merituar për punën e kryer. Dhe prandaj në pyetjen e bërë se nëse do të emigronit, në cilin vend do të shkonit, morëm ca përgjigje: Zvicër, Amerikë, Angli, Francë, Norvegji, Suedi, Zelandë e Re, etj.

Të gjitha këto ndodhin si rezultat i papunësisë, të cilën do ta cekim shkurtimisht më poshtë. Papunësia është një nga sëmundjet më të rënda makroekonomike. Ajo është simptomë e recesionit.

Sipas Ueb-faqes amerikane për biznes dhe teknologji Business Insider, që bëjnë analizën e papunësisë dhe inflacionit të vendeve, për vitin 2013 Kosova renditet e nënta me këto të dhëna:

Indeksi i varfërisë ishte 53.6 %, Inflacioni 8.3%, kurse Papunësia përfshin afër gjysmën e popullsisë me 45.3%.

Kemi disa lloje të papunësisë: Papunësia e fërkimit, strukturore, ciklike, sezonale, e detyruar, e vullnetshme. Në Kosovë ka prej të gjithave këtyre llojeve.

Papunësia e fërkimit (frikionale) shfaqet nga lëvizshmëria e njerëzve në vende të ndryshme për të kërkuar punë. Në këtë rast derisa ata kërkojnë punë quhen të papunë vullnetarë. Kjo është prezente pa dyshim në Kosovë dhe Maqedoni, ku njerëzit lëvizin për të gjetur punë. Me heqjen e vizave për Maqedoninë, qytetarëve të saj iu bë edhe më i shprehur ky lloj i papunësisë, sepse bëhet lëvizja nga Maqedonia për në vendet e Europës për të kërkuar punë.

Papunësia strukturore paraqitet kur kemi mospërputhje në mes kërkesës dhe ofertës për punë, dhe e tëra kjo ndodhë sepse kërkesa për një lloj pune rritet derisa kërkesa për një lloj tjetër pune bie dhe oferta nuk i përshtatet shpejtë këtij ndryshimi. Këtu ka të bëjë pjesë edhe imobiliteti profesional dhe imobiliteti gjeografik. Imobiliteti profesional është mos përshtatja e më të moshuarve ndaj disa profesioneve të reja, ku hasin në pengesa gjatë punës për shkak të risive. Kurse imobiliteti gjeografik na shfaqet kur njerëzit nuk mund t'i përshtaten ambientit të punës, apo vendit ku ata punojnë apo udhëtojnë për të punuar.

Papunësia ciklike shfaqet në fazën e rënies ekonomike, kur edhe ndodh rënia e kërkesës për të mira dhe shërbime, me çka prodhimi reduktohet dhe firmat do të kërkojnë më pak punë. Kjo është e shfaqur në Kosovë dhe në Maqedoni, ngase firmat prodhojnë pak dhe si shkak i kësaj kanë më pak të ardhura dhe kërkojnë më pak punëtorë.

Papunësia sezonale lidhet me prodhimin stinor, e cila shfaqet në industrinë e ndërtimit, në bujqësi, në shërbime, në turizëm, etj. Kështu për shembull disa njerëz një periudhë punojnë, kurse kur nuk ka punë ata detyrohen që të mos punojnë. Raste të tilla kemi edhe në Maqedoni, ku disa qytetarë punojnë disa muaj në Europë dhe pastaj qëndrojnë në shtëpi për disa muaj

duke mbijetuar me paratë e fituara.

Papunësia e vullnetshme paraqitet në rastin kur pagat janë fleksibile, jo të ngurtësuara, gjë që i bën më të sigurtë punëtorët. Por në këtë rast pjesa e pazënë me punë dëshiron paga më të larta dhe për këtë arsye quhet papunësi e vullnetshme.

Papunësia e detyruar vjen si rezultat i pagave jofleksibile, të cilat i detyrojnë punëtorët të mos punojnë. Kjo është një papunësi e cila ndodh në Kosovë dhe Maqedoni, ngase shumë prej punëtorëve nuk kanë sigurim, as nuk i regjistrohet përvoja e punës, pra ai punon vetëm për ditën e sotme. Kështu që shumë njerëz obligohen të mos punojnë dhe quhen si të papunë të detyruar, sepse vullneti i tyre kundërshtohet me mundësitë.

Gjithashtu një nga problemet kryesore të ekonomisë është shpërndarja e të ardhurave, gjë e cila lidhet me pyetjen "për kë të prodhohet".

Çka do të thotë kjo? E tëra lidhet me fuqinë e shtetit apo firmave për të prodhuar dhe shitjen e tyre deri tek konsumatori. Por si të vijmë deri tek kjo? Duhet shikuar gjendjen ekonomike të konsumatorit për të blerë ato të mira materiale dhe ato shërbime. Rruga deri tek arritja e prodhimit deri tek konsumatori nuk është aq e lehtë, e sidomos kur bëhet fjalë për një vend të varfër. Duhet menduar se çfarë prodhime pëlqejnë konsumatorët, që ato prodhime të arrijnë deri tek vendi i duhur dhe të arrihet qëllimi kryesor – profiti. Pra, gjithçka lidhet me mundësinë e konsumatorëve për të blerë dhe me shijet e konsumatorëve.

Në ekonominë e tregut, faktorët bazë të përcaktimit të shpërndarjes së të ardhurave janë: pronësia mbi faktorët e prodhimit dhe çmimet e faktorëve.

Çmimi i faktorëve përcaktohet në tregjet e faktorëve, kurse faktorët e prodhimit janë tri: puna, kapitali dhe toka.

Faktorët e prodhimit duhet vënë në përdorim për të arritur deri tek suksesi. Jo rastësisht e kemi përforcimin e Turqisë në ekonomi. Si erdhi deri këtu Turqia?! Me vjedhje, hajni, mashtrim, korrupsion, apo me premtime të kota në fushatat parazgjedhore?! Jo, me asnjërin prej këtyre, por vetëm me punë, me drejtësi, me mbajtje të premtimeve, me thjeshtësi e modesti.

Dhe vet kryesministri i Turqisë Rexhep Taip Erdogan kur u pyet se si e keni arritur këtë nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, është përgjigjur: „Thjesht, duke mos vjedhur!“

Kurse në Kosovë do të ishte lehtë që të arrihej një ekonomi e fortë, gjë e cila do ta përmirësonte shtetin dhe do ta bënte një mirëqenie të mirë për qytetarët. Pse do të ishte lehtë?! Sepse, ka një popullsi me numër jo të lartë të banorëve, dhe menaxhimi i buxhetit po të bëhej drejtë, atëherë do të ulej dukshëm varfëria, ngase rrogat normalisht se do të rriteshin, sepse ashtu e meriton populli, dhe kjo do të sillte një kënaqësi të madhe tek qytetarët. Problemi nuk është se nuk ka para, por se paratë nuk i jepen popullit, por harxhohen me pa të drejtë nga pushteti. Çdo projekt që bëhet, ca para futen në xhep të mbajtësit të pushtetit, një pjesë e vogël investohet në projekt, e ndoshta edhe aspak, kurse populli mbetet pa asgjë duke mos ditur të kërkojë atë që i takon.

Pasi se në këtë artikull kemi futur edhe mendime të qytetarëve të tjerë, atëherë për fund po e paraqesim edhe pyetjen e fundit, ku pyetja ishte kështu: „Si janë çmimet në Kosovë?! Tregoni shembuj për ca artikuj!“ Edhe këtu mora përgjigje që pritëshin të ishin ashtu. Ishin të singertë,

vërtetë vështirë të kesh çmime europiane me rroga tepër të ulëta. Ja disa përgjigje: shumë çmimet e larta; 1,85 € një litër vaj (më i liri); 40 cent buka, rreth 1.90 euro 1 litër vaj, 15 euro 25 kg miell e shumë e shumë të tjera, kurse rroga mesatare është 200 euro, shprehet i pikëlluar një qytetar.

Gjithashtu edhe në pyetjet për qytetarët shqiptarë të Maqedonisë arrita të marr përgjigje identike, ku thuhej se rrogat janë tepër të ulëta, kurse nga ana tjetër ka çmime shumë të larta. Vlen të ceket edhe projekti "Shkupi 2014" në të cilin janë harxhuar aq të holla sa që po të shfrytëzoheshin për zhvillimin e shtetit, besoj se do të hiqej varfëria dhe Maqedonia do të bëhej një shtet i fuqishëm ekonomikisht dhe larg varfërisë. Pra, i tërë problemi qëndron në faktin se buxhet (para) ka, por menaxhimi i tyre bëhet padrejtësisht. Nuk menaxhohen ashtu si duhet, bëhen vjedhje dhe mashtrime. Fajin e kanë ata që na udhëheqin.

Rritja ekonomike paraqet aftësinë e ekonomisë së një vendi për të prodhuar sa më shumë mallra e shërbime. Ajo lidhet ngushtë me standardin e jetesës së popullsisë së një vendi.

Përmirësues i standartit jetësor është prodhimi për frymë të popullsisë. Domethënë prodhimtaria duhet të rritet me ritëm të lartë krahas numrit të madh të popullsisë.

Gjithçka që duhet bërë është të punuarit më shumë dhe shpërndarja e të ardhurave në formën e duhur, duke mos vjedhur, gënjyer e premtuar kot. Pastaj pas rregullimit të këtyre do të ketë një ngritje të standartit jetësor, një ekonomi të fortë dhe një mirëqenie të mirë ekonomike.